

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

Nr.Prot: PR 0093

Data: 13.08.2021

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

I. Objekti i Fteses per Oferte

Sherbim pastrimi per zyrat qendrore dhe njesite e biznesit te ProCredit Bank sh.a.

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

1. Ftesa per oferte - 3 Faqe
2. Aneksi Nr. 1 - 1 Faqe
3. Aneksi Nr. 2 - 1 Faqe
4. Aneksi Nr. 3 - 3 Faqe
5. Aneksi Nr. 4 - 2 Faqe
4. Letra Antikorrupsion - 1 Faqe
5. Formulari i Ofertes - 1 Faqe
6. Deklarate per gjendjen gjyqesore- 1 Faqe
7. Pyetesori ILO- 2 Faqe

II. Oferta

A. Oferta Teknike-Ligjore, e cila paraqet *Kriteret e Pranimi/Kualifikimit dhe duhet te perpilohet sipas kerkesave te renditura me poshte:*

1. Subjekti duhet te provoje qe eshte i regjistruar ne regjistrin tregtar dhe per kete duhet te paraqese nje kopje te Ekstraktit Historik, te leshuar nga **Qendra Kombetare e Biznesit**.
2. Subjekti duhet te paraqese nje deklarate nga perfaqesuesi i shoqerise i cili deklaron qe subjekti nuk eshte ne proces falimentimi, nuk eshte denuar per shkelje penale, nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prete, qe lidhet me aktivitetin profesional (sipas formes bashkangjitur).
3. Subjekti duhet te paraqese nje dokument qe verteton se ka plotesuar dhe shlyer detyrimet fiskale si dhe sigurimet shoqerore, leshuar nga **Administrata Tatimore**.
4. Subjekti duhet te paraqes autorizim mjedisor ne rast perdorimi te solventeve gjate pastrimit, ne rast te kundert duhet te deklaroje qe nuk perfshihen keto produkte ne pastrimin e ambienteve.

Shenim: Dokumentacioni i kerkuar ne Kriteret e Pranimi/Kualifikimi ne pikat nga 1 dhe 3, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar jo me pare se tre muaj nga data e fundit e dorezimit te ofertes. Dokumentat e mesiperme mund te paraqiten origjinal/ te noterizuar ose kopje te dokumentave origjinale.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

Ofertuesit të shpallur fitues do të kërkojnë ky dokumentacion në origjinal ose të noterizuar.

Dokumentacioni i profilin të shoqërisë dhe elemente të tjera teknik:

1. CV të shoqërisë për aktivitetin e saj që nga data e themelimit.
2. Letër referencë e leshuar nga institucione të ndryshme private apo publike për të cilët shoqëria juaj ka kryer realizime të ngjashme se bashku me kopjet e kontratave përkatëse.
3. Listë të shoqërive për të cilat keni ofruar/realizuar shërbime të njëjta ose të ngjashme në 3 vitet e fundit.
4. Të gjitha detegjentet që do të përdorni për pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Bankës duhet të kenë logon Eco Friendly (pa lëndë toksike/helmuese) për të cilat është e nevojshme të na dërgoni skedën teknike përkatëse. Për çdo dërgimtë/qesë/produme të tjera etj të propozuar për furnizim është e nevojshme të kemi dhe mostrat përkatëse.
5. Listë e punonjësve të shoqërisë, shoqëruar me formularët e listës pagesave në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për periudhën Maj-Korrik 2021.
6. Listen me pasigjet që përdoren për pastrimin rutine dhe për pastrimet gjenerale/specializuara. Në lidhje me fasadën HO ju lutem dërgoni informacione për mënyrën e pastrimit duke marrë në konsideratë pozicionimin e tij.
7. Në oferten teknike duhet të përfshihet dhe informacioni për pagën që do të paguani punonjësit e pastrimit që do të angazhohen për ofrimin e shërbimit në ProCredit Bank.
8. Kopje të certifikatave ISO nëse dispononi.

Shënim i rëndësishëm:

Kërkesa e sipërpermendur për materialet Eco Friendly është kusht i detyrueshëm i vendosur nga Banka. Plotësimi i këtij kriteri është kusht kualifikues.

Me shoqërinë e cila do të shpallët fituese Banka do të sigurohet që furnizimi i materialeve të konsumueshme do të jetë i njëjti me mostrat e sjella gjatë procesit të tenderimit.

- B. Oferta Ekonomike**, e cila duhet t'u përmbahet kërkesave të **Aneksit Nr. 1, 2, 3** bashkangjitur kësaj ftese për ofertë. Çmimet e ofruara **duhet të përfshijnë TVSH-në**, materialet ndihmëse për realizimin e shërbimit, detegjentet përkatës për realizimin e shërbimit, sigurimin e punonjësve etj. Monedha e kuotuar duhet të jetë në **Leke**.

Letra Anti korrupsion dhe Pyetesori ILO: Bashkangjitur me ftesën për ofertë është Letra Antikorrupsion dhe Pyetesori ILO që duhet të firmoset/vulosen nga shoqëria juaj dhe të dërgohet bashku me **oferten tekniko-ligjore**.

Formulari i Ofertes: Bashkangjitur me ftesën për ofertë është Formulari i Ofertes i cili duhet të firmoset/vulohet nga shoqëria juaj dhe të dërgohet se bashku me **oferten ekonomike**.

III. Dorezimi i Ofertes

Oferta juaj duhet të jetë e ndarë në **dy zarfa të ndryshme. Dokumentacioni ligjor dhe teknik duhet të jetë në një zarf dhe oferta ekonomike në një zarf tjetër.**

Të dyja keto zarfe të cilat duhet të shënojnë qartë se çfarë përmbajnë. Zarfat duhet të jetë të vulosur nga shoqëria në pjesën e ngjitjes së tyre. Ata duhet të ketë të shkruar qartë: **Sherbim pastrimi për zyrtarë qendrorë dhe njesitë e biznesit të ProCredit Bank sh.a.**, si dhe **Emrin e Shoqërisë** që e dërgon. Zarfat duhet të protokollohen pranë recepsionit të Zyrave Qendrore të PCB-se dhe Shoqëria duhet të sigurohet që kjo ofertë është protokolluar. Për të shmangur çdo paqartësi, kërkojmë që përfaqësuesi i shoqërisë të mos largohet nga Zyrtarë Qendrorë të PCB-se pa marrë numrat e protokollit të ofertes. **Në total duhet të jenë dy numra protokoll.**

Në rast se oferta juaj dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ajo e kërkuar më lart, oferta nuk do të konsiderohet e vlefshme.

Ofertat tuaja, në zarfe të mbyllur dhe të vulosur, në formatin e kërkuar do të adresohen dhe paraqiten në:

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

Ref: 20210616

- Sherbim pastrimi per zyrat qendrore dhe njesite e biznesit te ProCredit Bank sh.a.

ProCredit Bank sh.a.
Rr. Dritan Hoxha
Laprake, Tirane

IV. Vleresimi i Ofertes

Banka do te vleresoje ofertat e marra konsideruar kriteret teknike si edhe oferten financiare dhe ruan te drejten te perzgjedhe oferten me te pershtatshme per nevojat e saj.

Afati i fundit per dorezimin e ofertave ne Banke, ne adresen e mesiperme eshte date **31.08.2021**
Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne:

info_procurement@procredit-group.com

Per cdo ankese ne drejtim te procesit te prokurimeve jeni te lutur te kontaktoni ne adresen :

albankesaprokurime@procredit-group.com

Banka do te njoftoje me shkrim nese ju jeni fitues ose jo per procesin e tenderimit.

Ju lutem percaktoni ne oferten tuaj menyren e marrjes se kesaj Ftese per Oferte duke vendosur nje kryq per nje nga menytrat e meposhtme;

- a. derguar me poste nga banka _____
- b. nepermjet internetit _____
- c. eshte terhequr prane bankes _____
- d. nga kompani te tjera _____

Sinqerisht,
ProCredit Bank sh.a



Aneksi Nr. 1: PASTRIMI I AMBIENTEVE TE BANKES

A. Pastrimi i sipërfaqes se njesive te biznesit dhe zyrave qendrore konsiston ne:

- Pastrim dysHEMEJE
- Pastrimi i plote cdo dite i ATM/Dropbox/paisje te tjera ne Zonat e vetesherbimit.
- Pastrimi ashensoreve, dorezave te dyerve sipërfaqeve qe jane me shume te prekshme me produkte me permbajtje alkoli
- Pastrimi koshave dhe zevendesimi i qeseve
- Pastrimi i kuzhines si dhe larja e eneve
- Pastrimi i dritareve (jo fasade)
- Pastrimi i pluhurave te kondicionereve
- Pastrimi i tavolinave, paisjeve informatike (PC, printera, etj)
- Pastrimi i etazhereve, dollapeve
- Pastrimi i parkingut te brendshem
- Pastrimi perpara deres hyrese
- Ne rastet e hapjes se njesive te reja te biznesit, pastrimi i pare i degeve te reja ose te rikonstruara do te behet sipas kerkeses se bankes nje dite para pastrimit.
- Pastrim te pllakave anesore dhe dysHEMEJE te tualeteve
- Pastrim te lavamanit – wc
- Pastrim te pasqyrave dhe aksesoreve te tjere
- Furnizimi dhe vendosja e aksesoreve (leter higjienike, leter duarsh, supun i lengshem per larjen e duarve, qese per mbeturinat lehtesisht te tretshme, etj).

Shenim i rendesishem:

- Sherbimi i pastrimit ne Njesite e Biznesit/Zonat e vetesherbimit do te kryhet cdo dite.
- Ne zonat e vetesherbimit ne Tirane dhe rrethe nuk ka tualete dhe rrjedhimisht nuk ka furnizim me uje. Gjithashtu duhet te merren masat per te marre gjithemone me vete paisjet e pastrimit pasi nuk ka mundesi magazinimi te tyre ne keto zona. Vetem Zyrtar Qendrore dhe Agjencia pjese e kesaj godine disponon magazinim dhe furnizim me uje.

Shenim 1 :

Ne cmim duhet te perfshihen te gjitha kostot qe ka shoqeria juaj per kryerjen e sherbimit te kerkuar:

- Fuqine punetore
 - Cdo detergjent qe nevojitet per realizimin e sherbimit me siper (p.sh. solucione per larjen e dyshemese, eneve, xhamave etj)
 - Materialet ndihmese (psh makinerite, kove, shtupe per larje etj)
 - Shpenzimet e transportit te materialeve te furnizuara ne ambientet per tu pastruar.
- Detergjentet qe do te perdorni per pastrimin e ambjenteve te Bankes duhet te jene me logo Eco Friendly (pa lende toksike/helmuese)
- Qeset plastike te mbeturinave duhet te jene te prodhuara nga material me prejardhje 100 % te ricikluar. Secila qese duhet te kete shenjen dalluese e cila tregon se kjo qese eshte prodhuar me 100% granulat te ricikluar.
- Furnizimi me llojet e materialeve per pastrim behet nga shoqeria juaj ne te gjitha njesite e biznesit te bankes.

Shenim 2 :

Lutem percaktoni kohen e reagimit dhe aftesine per te kryer sherbimin e pastrimit ne raste emergjente:

Per distanca deri ne 50 km: _____ ore

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

Per distanca deri ne 150 km: _____ ore

Per distanca me shume se 150km: _____ ore

B) Pastrimi i fasadave te xhamit.

Pastrimi i fasadave te xhamit/light box (reklama horizontale me ndricim) konsiston ne:

- Pastrim profesional (brenda dhe jashte) nje here ne muaj te gjithë fasades se degeve/agjensive.
- Pastrim i thjeshte ne menyre te vazhdueshme deri ku eshte e arritshme prej punonjesve.
- Per fasaden e zyrove te drejtorise qendrore pastrimi do te kryhet vetem me njoftim paraprak nga ana e bankes (fasada e drejtorise qendrore pastrohet mesatarisht 1 here ne vit, por kjo eshte e ndryshueshme sipas kerkeses se paraqitur nga Banka).
- Pastrimi i reklames horizontale me ndricim (light box) eshte i perfshire ne cmim.
- Ne rastet e hapjes/rialokim te njesive te reja te biznesit, pastrimi i fasadave do te behet sipas kerkeses se bankes nje dite para pastrimit.

Shenim 1:

Ne cmim duhet te perfshihen te gjitha kostot qe ka shoqeria juaj per kryerjen e sherbimit te kerkuar:

- Fuqine punetore
- Cdo detergjent qe nevojitet per realizimin e sherbimit per pastrimin e fasadave, light box-eve
- Materialet ndihmese (psh makinerite, shkalle, skela, vinc, kove, etj)
- Shpenzimet e transportit te materialeve ne furnizuar ne ambientet per tu pastruar

Furnizimi i materialeve per pastrimin e fasadave behet nga shoqeria juaj ne te gjitha njesite e biznesit te bankes.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

Aneksi Nr. 2: PASTRIM I AMBIENTEVE TE TJERA TE BANKES

Banka ka ne perdorim :

- a) Arkiva Vore me siperfaqe:
Kati i I – (Zyre +1 Tualet)-9 m2 si dhe Arkiva- Ne total siperfaqia 1047 m2
Vendodhja e Arkives ne Vore, Tirane.

Lutemi jepni oferten Tuaj te detajuar si me poshte:

Nr	Ambienti	Tualete	Siperfaqja e dyshemese per pastrim /m2	Cmimi ne leke me tvsh/m2 per pastrimin e dyshemese	Totali ne leke me tvsh per pastrimin e dyshemese
1	Kati I Arkiva Vore		1047		
2	Zyre ,Arkiva Vore		9		

Shenim 1:

Ne cmim duhet te perfshihen te gjitha kostot qe ka shoqeria juaj per kryerjen e sherbimit te kerkuar:

- Fuqine punetore
- Cdo detergjent qe nevojitet per realizimin e sherbimit me siper (p.sh. solucione per larjen e dyshemese, eneve, xhamave etj)
- Materialet ndihmese (psh makinerite, kove, shtupe per larje etj)
Shpenzimet e transportit te materialeve te furnizuara ne ambientet per tu pastruar

Shenim 2:

Kati i pare ku ndodhet Zyra dhe nje tualet ne Arkive do pastrohet cdo dite pune.

Ne Aneksin nr.3 mund te gjeni informacion reference mbi siperfaqen e dyshemeve, fasadave ne njesite e biznesit si dhe zyrat qendrore te ProCredit Bank sh.a qe kane nevoje per pastrim.
Lutemi jepni ofertat tuaja ne leke me tvsh duke plotesuar tabelen ne kete aneks.

Aneksi Nr. 3: Oferta Ekonomike

1. Furnizimet e materialeve:

Per cdo furnizim me materialet e pastrimit shoqeria do te kujdeset me perparaesi qe te plotesohen te gjitha kerkesat e Bankes ne kohe dhe me cilesi.

2. Pasqyrat me te dhenat per siperfaqet e dyshemeve, fasadave si dhe numrin e tualeteve:

Nr .	Njesi biznesi	Adresa	Tuale te/ cope	Siperfaqja e dyshemeve per pastrim /m ²	Siperfaqja e fasades per pastrim /m ²	(1)Cmi mi ne leke me tvsh/m ² per pastrimin e DYSHEMESE	(2)Cmi mi ne leke me tvsh/m ² per pastrimin e FASADES	TOTALI NE LEKE ME TVSH PER PASTRIMIN E DYSHEMESE	TOTALI NE LEKE ME TVSH PER PASTRIMIN E FASADES
1	HO Agency	Agjensia prane HO, Rr. Dritan Hoxha, Laprake	1	116.00	140.00				
2	Korca	Rr"Midhi Kostani"	2	245	97				
3	Durres	Porti, Lagjia 3, Rruga "Skënderbej" Pranë qendrës "Monum" Durrës.	1	96.00	8.00				
4	Shkoder	Lagjia Qemal Stafa, Bulevardi Zogu i Parë,	0	51	17				
5	Bulevardi "Zogu I"	Bulevardi "Zogu I"	0	27	13.5				
6	Square 21	Rr. Kavajes	0	39	12				
7	Fier	Fier	0	35	78				
8	HO*	Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane	21	3,044.70	2,071.00				
TOTAL									

* Pastrimi i fasades HO do te kryhet sipas kerkeses se bankes

Aneksi Nr. 4: Kushtet paraprake te kontrates

Banka ruan te drejten e ndryshimit te ketyre kushteve paraprake:

1. Ftesa per Oferte dhe Oferta perbejne kontraten midis paleve deri ne daten e firmosjes nga te dy palet te kontrates me shkrim.
 2. Sipermarresi do te kryeje sherbimin e pastrimit te ambjenteve te Bankes dhe furnizimin me aksesoret dhe materialet per realizimin e sherbimit, ne te gjitha njesite e Bankes dhe Banka do te paguaje per sherbimin e kryer
 3. Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit nga palet dhe eshte e vlefshme per nje periudhe kohore prej _____ nga data e nenshkrimit.
 4. Personi i autorizuar: I autorizuar per te vepruar ne emer te blesesit ne lidhje me ekzekutimin e kontrates eshte Njesia e Administrates.
 5. Vendi i kryerjes se sherbimit jane te gjitha njesite e biznesit dhe ambientet e Bankes sipas percaktimeve te kesaj ftese per oferte.
 6. Detyrimet e Sipermarresit
- 6.1 Sipermarresi merr persiper te kryeje sherbimet ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kontrate, duke respektuar etiken dhe kushtet specifike te aktivitetit te bankes si dhe te gjitha legjislacionin shqiptar ne fuqi, ne vecanti kerkesat e sigurimit teknik ne pune te punonjesve te tij.
 - 6.2 Sipermarresi garanton se aksesoret dhe materialet e furnizuara jane funksionale, sipas kushteve dhe standarteve te higjenes se kerkuara nga legjislacioni shqiptar. Ne rast se ndodh ndryshe, ato do te zevendesohen me shpenzimet e Sipermarresit.
 - 6.3 Sipermarresi do te jete pergjegjes per sigurimin teknik te punonjesve gjate gjitha veprimtarise si edhe do te permbush te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise lidhur me rreziket per humbjen dhe/ose demtimin e materialeve dhe pajisjeve ne pune, plagosjen dhe/ose vdekjen e personelit ne pune duke shlyer te gjitha detyrimet ndaj shtetit dhe punonjesve te tij. Sipermarresi mban pergjegjesi ligjore, administrative, financiare, ekonomike, etj gjate gjitha kohezgjatjes se kesaj kontrates.
 - 6.4 Sipermarresi duhet te zevendesojte ata punonjes te tij ndaj te cileve Banka shpreh rezerva dhe ka verejtje lidhur me performancen e tyre ne pune, cilesine e punes se kryer, mosrespektimin dhe shperndarjen e informacionit konfidencial qe perfitohet ne menyre te pavullnetshme vetem si shkak i marredhenieve te punes ne objektet e bankes. Sipermarresi reagon jo me vone se dy dite pune pas njoftimit prej Bankes.
 - 6.5 Sipermarresi detyrohet te demshperbleje Banken per te gjitha demet qe do te shkaktohen nga sherbimet e kryera prej tij jo konform kushteve te kontrates dhe/ose ne shkelje te ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, nga perdorimi i materialeve, aksesoreve, pajisjeve apo makinerive jo konform kontrates, kushteve dhe standarteve teknike, veprimeve neglizhente apo te qellimshme te Sipermarresit.
 - 6.6 Sipermarresi, per pastrimin e ambjenteve te Drejtorise se Pergjithshme te Bankes parashikon pastrimin e tyre jo vetem gjate paradites (kohes zyrtare te punes) por edhe pas orarit zyrtar te punes. I gjitha procesi i pastrimit ne kete periudhe kohore, mbikqyret nga punonjesit e sigurise se bankes. Ne keto raste Sipermarresi nuk vepron/punon ne asnje rast jashte prezences se punonjesve te sigurise. Per kete sherbim (jashte kohes normale te punes dhe ne ditet e pushimit zyrtar). Sipermarresi paraqet Bankes nje grafik mujor pastrimi me emrat dhe gjeneralitetet e duhura te punonjesve te saj.
 - 6.7 Sipermarresi kryen sherbimin e pastrimit te fasadave te xhamit ne objektet e bankes, sipas planifikimit.
 - 6.8 Sipermarresi nuk mund ne asnje rast te nenkontraktojte shoqeri apo persona te tjere per te kryer te njejtin sherbim te parashikuar ne kete kontrate pa miratimin me shkrim te bankes.
 7. Banka kryen pagesen brenda dates 30 te muajit per muajit paraardhes si dhe perkundrejt paraqitjes se fatures tatimore. Pagesa do te behet ne llogarine e sipermarresit _____ ne Banken ProCredit. Sipermarresi duhet te cel llogari (nese nuk ka) ne Banken ProCredit brenda 48 oreve nga shpallja fitues.
 8. Konfidencialiteti: Palet ndalohen te japim ne pale te treta informacion te fituar gjate ekzekutimit te kesaj kontrate si dhe cdo informacion ne lidhje me kete kontrate. Palet do te respektojte te gjitha standartet dhe parimet e etikes dhe biznesit ne veprimtarine e tyre ne kuader te kesaj kontrate.
 9. Banka ka te drejte te zgjidhe kontraten ne cdo kohe me njoftim me shkrim paraprak dy muaj perpara.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

10. Ne rast se mosmarreveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim, palet i drejtohen gjykates se shkalles se Rrethit Gjyqesor, Tirane.

Sipermarresi

Vertetoj se kam lexuar, kuptuar Ftesen per Oferte dhe ne perputhje me kerkesat e saj bashkangjitur gjeni oferten e _____.

Emri i sipermarresit:

Nenshkrimi i autorizuar:

Vendi:

Data:

Letra Antikorrupsion (Deklarata e Perputhshmerise)

Grupi ProCredit vlereson se ndikimet etike, shoqerore dhe mjedisore jane pjese e rrjetit te furnizimit. Veç kesaj, ndikimet pozitive mund te arrihen permes blerjes se produkteve dhe/ose sherbimeve me te pergjegjshme, si dhe duke punuar bashkerisht me furnitorët për të ndikuar pozitivisht në performancën etike, shoqerore dhe mjedisore. Ndaj, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve/kontraktoreve të tij që t'i përmbahen një pakete standardesh minimale për të garantuar pajtueshmërinë e angazhimeve të tyre për çështjet kryesore shoqerore, mjedisore dhe të administrimit me standardet e larta të ProCredit.

Njesoj siç veprohet me klientët, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve dhe kontraktoreve të tij që të mos angazhohen në asnjë prej veprimtarive të renditura në Listën e Perjashtimit të ProCredit. Aktivitetet me të rendesishme, por jo të vetmet, që përmban kjo listë janë:

-Prodhimi ose veprimtaritë që përfshijnë forma të demshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar/punës së demshme për femijet, praktikën diskriminuese ose praktikën që i pengojnë punonjësit të ushtrojnë në mënyrë të ligjshme të drejtat e tyre të lirise së organizimit dhe të negociimit kolektiv (për hollësi të mëtejshme, shihni pikën a) të Listës së Perjashtimit)

-Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, si dhe konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti apo veprimtarie (për hollësi të mëtejshme, shihni pikën e) të Listës së Perjashtimit)

-Shoqëria konfirmon se nuk kryen aktivitete tregtare të gjendura në listën perjashtimore të ProCredit Grup.

-Duke qenë se Grupi ProCredit i përmbahet Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) pret që të njejtën gjë të bëjnë edhe furnitorët dhe kontraktorët e tij. Kështu, shoqëria tregtare konfirmon se iu përmbahet standarteve dhe etikës me të lartë të biznesit gjatë procesit të tenderit dhe gjatë zbatimit të kontratës. Ajo zbaton standartet e Shëndetit, Sigurisë në punë, Sigurisë Mjedisore dhe standartet e ILO dhe nuk është e përfshirë në punën e detyruar ose në punën e paligjshme të fëmijëve. Gjithashtu shoqëria konfirmon se nuk është e përfshirë në praktikën diskriminuese apo praktikën që ndalojnë punëmarresit e saj për të ushtruar të drejtën e tyre ligjore për t'u mbledhur dhe anëtarësuar në organizatat e punëmarresve.

-Shoqëria pranon se përfshirja e saj në një nga praktikën e paligjshme të përmendura më sipër, do të sjellë perjashtimin e saj nga procedura e tenderimit ose ndërprerjen e kontratës në mënyrë të menjehershme nga ana e ProCredit Bank sh.a.

- Siç përcaktohet në Kodin e Sjelljes, Grupi ProCredit nuk toleron rastet e pastrimit të parave, mitmarrjes dhe korrupsionit. Prandaj, marrëdhëniet e biznesit nuk mund të krijohen ose të vazhdojnë në rast se mesohet që një furnitor potencial është i përfshirë në rastet e pastrimit të parave, korrupsionit dhe/ose mashtrimit. Thëksohet se Grupi ProCredit nuk pranon rryshfete të asnjë forme dhe as nuk pranon angazhimin e furnitoreve në praktikën e tillë. *Furnitorët dhe kontraktorët që rezultojnë të përfshirë në veprimtari të kësaj natyre, do të perjashtohen nga mundësia për t'u bërë partnerë.*

-ProCredit Bank do të refuzojë ofertat pjesëmarrëse në tender, nëse deshmohet ose nëse konsiderohet se shoqëria është e përfshirë në ndonjë rast të pastrimit të parave, mashtrimit ose në raste korrupsioni gjatë procesit të tenderit ose do të anulohet kontrata nëse deshmohet se ka ndodhur ndonjë nga keto raste gjatë procesit të dhenies së kontratës.

-Për qëllimet e kësaj politike aktivitete të mëposhtme do të konsiderohen si korrupsion:

- a) Veprimin e të dhenit, pranuarit ose kerkimit të mjeteve të çfaredo vlere, për të ndikuar të ndonjë person tjetër juridik, personel të PCB-se ose të ndonjë shoqëri tjetër, gjatë procesit të tenderimit ose gjatë dhenies së kontratës.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

- b) Demtimin e pronës së PCB-se, kercenimin e personelit të PCB-se, kercenimin për demtim të reputacionit të PCB-se ose ndonjë shoqëri tjetër për të ndikuar në procesin e tenderimit ose për zbatimin e kontratës së dhënë.
- c) Marreveshjen në mes të dy ose më shumë shoqërive për të imponuar ose për të ndikuar në tenderet e papershtatshëm, tendere me çmime artificiale ose çmime jo konkurruese.
- d) Falsifikimin e qellimshëm, ndryshimin, fshehjen ose paraqitjen e gabuar të informatave të kërkuara ose të paraqitura gjatë procesit të tenderit ose gjatë zbatimit të kontratës.

-Për qellimet e kësaj politike veprime të mashtimit konsiderohen përpjekjet ose pakujdesitë e qellimshme për të mashtuar ose përpjekjet për të mashtuar stafin e PCB-se ose shoqërive të tjera, në mënyrë indirekte ose të drejtpërdrejte, për të përfituar financiarisht ose për t'ju shmangur detyrimeve të përcaktuara me kontratë ose me ligj.

Grupi ProCredit pret prej furnitoreve të tij të angazhohen dhe të respektojnë ndershtetërisht standardet e përcaktuara në këtë dokument. Furnitorët priten të demonstrojnë angazhimin e tyre duke bashkëpunuar ngushtësisht me Grupin ProCredit, si dhe duke ofruar akses të arsyeshëm në dokumentacionin/informacionin përkatës, nëse gjykohet e nevojshme. Në rastin e shkeljeve të rënda dhe/ose të vazhdueshme të standardeve të përcaktuara në këtë dokument, Grupi ProCredit do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për ndërprerjen e marrëdhënieve të biznesit.

Me nënshkrimin e këtij dokumenti, nënshkruesit konfirmojnë autoritetin e tyre për të nënshkruar në emër të furnitorit dhe për t'u angazhuar për respektimin e standardeve të përcaktuara në të.

Deklarata për t'u nënshkruar nga furnitori/kontraktori

Emri i kompanisë

Numri i regjistrimit

Numri i kontratës/tenderit

Adresa

Data

Nënshkrimi i autorizuar

Emri

Titulli

Pyetësi ILO

Pyetësi i ILO-s për përputhshmërinë e furnitoreve

1. Informacione të përgjithshme

Emri i kompanisë	
Produktet kryesore dhe sektori	
Shteti/shtetet e prodhimit/operimit	
A i eksportoni/ofroni produktet/shërbimet tuaja në vendet e BE-së?	

2. Shëndeti dhe siguria profesionale

A ka vendosur dhe a zbaton kompania juaj procedurë për shëndetin dhe sigurinë profesionale në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare të industrisë për të parandaluar aksidentet, dëmtimet dhe sëmundjet? A mund të rendisni disa nga udhëzimet/standartet dhe procedurat përkatëse? Sa shpesh rishikohen apo monitorohen ato?	
A ka kualifikime/trajnime specifike që duhet të kete stafi juaj për të kryer detyrën e caktuar? Si i ndiqni nevojat për trajnim? Një herë në sa kohë zhvillohen trajnime?	
Si e ndiqni dhe si e raportoni shkallën e dëmtimeve, sëmundjeve profesionale, ditët e mungesave, fenomenin e të munguarit në punë dhe numrin e viktimave që lidhet me punën?	
Si i parandaloni zjarret dhe çfarë do të bënit ju dhe stafi juaj në rast emergjence për shkak të një zjarri?	
Nëse pyetja vlen për kompaninë në fjalë: A e pajisni stafin me pajisje mbrojtëse? Nëse po, çfarë pajisjesh?	

3. Barazia në mundësi dhe në trajtim

Si e ndiqni diversitetin në kompaninë tuaj?	
Si e parandaloni diskriminimin në kontekstin e rekrutimit, shpërblimit dhe ngritjes në detyrë? A keni mekanizma për shqyrtimin e ankesave?	
A aplikoni mekanizma/politika/programe specifike për të inkurajuar grupe apo grupet e tjera të vulnerabël? Për shembull, këtu mund të përfshihen targetet lidhur me raportin specifik femra-meshkuj, programe mentorimi të projektuara specifikisht, si dhe koncepte specifike për komunikimin me grupet vulnerabël.	

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri

a. Dokumentacion shtese

Ju lutemi, ndihuni te lire t'i bashkengjitni pergjigjes suaj per pyetjet e mesiperme dokumentet perkatese (pra, procedura, udhezime, politika dhe standarde, nese deshironi).

b. Konfirmimi

Data dhe vendi

Emri i plote dhe pozicioni

Firma

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne se kane autoritetin te nenshkruajne ne emer te kompanise dhe te japin pergjigje plotesisht te verteta.

FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet të plotësojë këtë Formular në përputhje me udhëzimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zëvendësime të këtij formati.]

Date: ____/____/____
[plotësoni datën (ditë, muaj, vit) e dorëzimit të ofertes]
Numri i ftesës :.....:

Per: **ProCredit Bank**
Njësia e Administratës
Tiranë, Shqipëri

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë që:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në këtë procedurë prokurimi dhe pranojmë, pa rezervë ose përjashtime, kërkesat, afatet dhe kushtet e shprehura në to;
- (b) Ne sigurojmë furnizimin në përputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levimit për Mallrat dhe Shërbimet respektive si më poshtë _____ [plotësoni shkurtimisht mallrat, apo shërbimet respektive];
- (c) Ne përmbushim gjithë kërkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike të specifikuara në dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorëzuara me këtë deklaratë.
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, përfshirë çdo detyrim tatimor është: _____ [plotësoni cmimin total të ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhën];
- (e) Oferta jone do të jetë e vlefshme nga data e dorëzimit të ofertes deri me datë.....;
- (f) Nëse oferta jone do të pranohet, ne angazhohemi të mbajmë një garanci kontrate në përputhje me dokumentat e tenderit nëse kjo është e aplikueshme;
- (g) Ne nuk kemi konflikt interesi në përputhje me Letren Antikorrupsion;
- (k) Ne kuptojmë se kjo ofertë, sëbashku me njoftimin tuaj zyrtar të shpalljes së fituesit do të shërbejë si një kontratë e perkohshme ndërmjet nesh, derisa të përgatitet dhe nënshkruhet kontrata zyrtare.
- (l) Ne kuptojmë që nuk jeni të detyruar të pranoni ofertën me cmimin më të ulët ose çdo ofertë tjetër që ju mund të merri.

Firmosur: _____

Date: _____

DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E shoqerise pjesemarrese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date _____ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt _____

Une i nenshkruari _____ me cilesine _____ te shoqerise _____ deklaroj se:

- Shoqeria _____ nuk eshte denuar per shkelje penale,
- Shoqeria _____ nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqeria _____ nuk eshte ne proces falimentimi

Data e dorezimit te deklarates _____

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

